



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 123, Datë 04.04.2023

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “SUN ENERGY SOLUTIONS” SH.P.K., NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW, NË FSHATIN SHEQ
MARINAS, TOPOJË, BASHKIA FIER**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4 pika 1, gërma “a”, 5 pika 1, gërma “a” dhe 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, i ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 04.04.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 571/9 prot., datë 30.03.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “Sun Energy Solutions” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Sheq Marinas, Topojë, Bashkia Fier”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 50, datë 20.02.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Sun Energy Solutions” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 21.02.2023 dhe 22.02.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 02.03.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresën nr. 571/3 prot., datë 03.03.2023, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht. Shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit nëpërmjet shkresës së protokolluar në ERE me nr. 571/4 prot., datë 07.03.2023.
- Për shkak të kohës së pamjaftueshme për të zhvilluar një korrespondencë të mëtejshme me shoqërinë për të sqaruar dokumentacionin që duhet të depozitonte në kuadër të këtij aplikimi, e po ashtu formën e depozitimit të tij, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 101, datë 20.03.2023, u vendos zgjatja deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë e afatit të vendimmarrjes së bordit mbi aplikimin e shoqërisë “Sun Energy Solutions” sh.p.k. për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 571/7 prot., datë 21.03.2023, shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues të këtij aplikimi.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); Shtojcën 1, Shtojcën 1A dhe Shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (Aneksi A).
- Aplikuesi ka kryer pagesën, sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “Sun Energy Solutions” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të rregullores për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.1, gërmat “a”, “b”, “d” “e” dhe “f”.
- Për sa parashikuar në VNM-në Paraprake në lidhje me zbatimin në terren të projektit dhe duke i’u referuar deklaratës së shoqërisë se nuk ka filluar ende punimet, vlerësohet që t’i lihet kusht që të informojë ERE-n çdo 2 (dy) muaj në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaiik, deri në datën 06.09.2024 (datë në të cilën përfundon dhe vlefshmëria e lejes aktuale).
- ERE, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se nga sa deklaruar nga shoqëria rezulton se jetëgjatësia e pritshme e centralit është 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërisë “Sun Energy Solutions” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në fshatin Sheq Marinas, njësia administrative Topojë, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar.
2. Shoqëria të informojë ERE-n çdo 2 (dy) muaj në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltai, deri në datën 06.09.2024.
3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI